



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

RREGULLORE (QRK) - Nr. 22/2023
PËR DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E QENDRËS SHETËRORE
TRAJNUESE PËR SIGURI KIBERNETIKE¹

¹Rregullore (QRK) - Nr.22/2023 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike është miratuar në Mbledhjen e 178-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 15/178 të datës 13.12.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 21 paragrafi (3) të Ligjit Nr.08L-173 për Sigurinë Kibernetike, (GZ, Nr. 4/27.02.2023), nenin 8 paragrafi (4) nën paragrafi (4.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (GZ, nr. 34/18 nëntor 2022), si dhe nenit 19 paragrafi (6.2) të Rregullores të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, (GZ, Nr. 15/12.09 2011),

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK)-NR.22/2023 PËR DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E QENDRËS SHTETËRORE TRAJNUESE PËR SIGURI KIBERNETIKE

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet nga MM/FSK dhe vlenë edhe për institucionet tjera të RKS-së, të identifikuar si audiencë pjesëmarrëse në trajnime si dhe operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **QSHTSK** - Qendra Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike;

1.2. **Cyber Range** – është një laborator ose mjedis simulimi i sulmeve kibernetike që përdoret për të zhvilluar ushtrime, trajnime dhe testim të politikave dhe procedurave të sigurisë duke ndihmuar institucionet të përmirësojnë reagimin ndaj sulmeve kibernetike.

1.3. **Ushtrime në fushën e sigurisë kibernetike** – janë aktivitete të simuluar për të testuar përgjigjen dhe qëndrueshmërinë e institucioneve ndaj sulmeve kibernetike, që shërbejnë në identifikimin e dobësive dhe përmirësimin e masave të sigurisë në sistemin e TI-së.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin sikur në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 4

Struktura Organizative

1. Struktura organizative e QSHTSK-së përbëhet por nuk kufizohet në:

- 1.1. Stafi udhëheqës;
- 1.2. Ekipi i trajnerëve;
- 1.3. Stafi mbështetës.

2. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës bëhet në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm të MM-së dhe FSK-së, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e QSHTSK-së

1. Harton dhe zbaton programet trajnuese në fushën e sigurisë kibernetike.
2. Në bashkëpunim me Agjencinë për siguri kibernetike (tutje ASK) përcakton nevojat për trajnime dhe ushtrime në fushën e sigurisë kibernetike.
3. Harton planin e punës dhe programin e trajnimeve për periudhën një vjeçare duke u bazuar në nevojat e përcaktuara nga paragrafi 2 i këtij neni.
4. Koordinon me institucionet shtetërore, operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale për pjesëmarrje në trajnime.
5. Ndhmon institucionet shtetërore, operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale të zhvillojnë skenarë të përshtatshëm për operacionet e tyre kibernetike.
6. Përgatit materiale trajnuese dhe materiale ndihmëse për trajnimet dhe ushtrimet që mbahen në QSHTSK.
7. Ofron qasje në platformat online të trajnimeve që janë të hostuara në këtë Qendër për të gjithë audiencën pjesëmarrëse.
8. Bashkëpunon me institucionet akademike në nivel vendi për realizimin e trajnimeve të planifikuara vjetore.
9. Operon dhe mirëmban Cyber Range.
10. Mban evidenca për realizimin e trajnimeve.

11. Bën analizën pas veprimit për të gjitha trajnimet dhe ushtrimet e mbajtura në QSHTSK.
12. Ofron dëshmi të pjesëmarrjes në trajnime dhe ushtrime në QSHTSK për të gjithë pjesëmarrësit.
13. Bashkëpunon me partnerë dhe aleatë për të realizuar misionin e Qendrës.

Neni 6

Audienca e synuar

1. QSHTSK ofron programe trajnimi në fushën e sigurisë kibernetike për zyrtarët publik si në vijim:
 - 1.1. për nëpunësit e shërbimit civil të punësuar në institucionet e RKS;
 - 1.2. për nëpunësit e shërbimit publik të punësuar në institucionet e RKS;
 - 1.3. për nëpunësit administrativ dhe mbështetës të punësuar në institucionet e RKS;
 - 1.4. për nëpunësit e kabinetit të punësuar në institucionet e RKS sipas nevojës dhe kërkesave;
 - 1.5. për nëpunësit e operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesve të shërbimeve digjitale.
2. QSHTSK në bashkëpunim me ASK-në organizon ushtrime në fushën e sigurisë kibernetike për:
 - 2.1. për nëpunësit e shërbimit civil të punësuar në institucionet e RKS;
 - 2.2. për nëpunësit e shërbimit publik të punësuar në institucionet e RKS;
 - 2.3. për nëpunësit administrativ dhe mbështetës të punësuar në institucionet e RKS;
 - 2.4. për nëpunësit e kabinetit të punësuar në institucionet e RKS sipas nevojës dhe kërkesave;
 - 2.5. për nëpunësit e operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesve të shërbimeve digjitale.

Neni 7

Programet e trajnimit dhe ushtrimeve

1. QSHTSK ofron Trajnime dhe ushtrime në fushën e sigurisë kibernetike, si në vijim:
 - 1.1. Trajnime specialistike në fushën e sigurisë kibernetike si:
 - 1.1.1. Trajnime për vetëdijesim për rreziqet në fushën e sigurisë kibernetike;

1.1.2. Trajnime teknike për përdorimin e veglave, teknologjive dhe teknikave specifike për t'u mbrojtur ndaj sulmeve kibernetike;

1.1.3. Trajnime për programet e certifikimit sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike;

1.1.4. Trajnime të personalizuar që janë të përshtatura për nevojat specifike të një institucioni.

1.1.5. Trajnime për të ndarë praktikat më të mira përmes shkëmbimit të përvojave me partnerët dhe aleatët.

1.2. Ushtrimet në fushën e sigurisë kibernetike në Cyber Range që:

1.2.1 Të praktikojë shkathtësitë dhe njohuritë teorike të zyrtarëve nga institucionet e RKS si dhe operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesve të shërbimeve digjitale;

1.2.2. Të praktikojë ndërveprimin e institucioneve të RKS, operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale;

1.2.3. Të organizojë dhe të marrë pjesë me partnerë vendor, rajonalë dhe ndërkombëtarë për të simuluar sfidat e sigurisë kibernetike përmes ushtrimeve të përbashkëta.

Neni 8 **Programet dhe Kurikulat trajnuese**

1. QSHTSK në bashkëpunim me ASK-në harton programet dhe kurikulat e trajnimeve për të gjithë personelin e angazhuar në fushën e sigurisë kibernetike.

2. Bazuar në programet dhe kurikulat e trajnimeve si dhe nevojave dhe kërkesave të institucioneve, QSHTSK harton planin vjetor për realizimin e trajnimeve.

3. Programi dhe kurikulat trajnuese në fushën e sigurisë kibernetike rishikohen dhe përditësohen çdo vit.

4. Rishikimi, shtimi ose largimi i ndonjë trajnimi të caktuar mund të bëhet edhe jashtë kohës së rishikimit të Programit trajnues me vendim të Ministrisë të Mbrojtjes sipas nevojës dhe kërkesave të përdoruesve nga institucionet të cilat janë audiencë pjesëmarrëse e trajnimeve e QSHTSK.

Neni 9

Përgjegjësitë e audiencës pjesëmarrëse në trajnime dhe ushtrime në QSHTSK

1. Të gjithë pjesëmarrësit në trajnime specialistike dhe ushtrime në fushën e sigurisë kibernetike në QSHTSK, paraprakisht duhet të kenë njohuri bazike në fushën e sigurisë kibernetike.
2. Përgjegjës për trajnimet bazike në fushën e sigurisë kibernetike për personelin e tyre të angazhuar në siguri kibernetike janë vet institucionet përkatëse.
3. Të gjithë pjesëmarrësit në trajnime dhe ushtrime në QSHTSK, duhet t'i nënshtrohen rregullave të brendshme të sigurisë të MM dhe FSK-së për hyrje/dalje dhe qëndrimit ditor brenda hapësirave të kësaj Qendre.

Neni 10

Format e trajnimit

1. Varësisht prej llojit të programit trajnues, trajnimet do të realizohen në këto forma:
 - 1.1. Trajnimi me prezencë fizike për programe trajnimi, ku pjesëmarrësit duhet të marrin pjesë fizikisht për të ndjekur trajnimin e caktuar;
 - 1.2. Trajnime me prezencë fizike në lokacione të ndryshme që do realizohen nga ekipe mobile të trajnerëve të QSHTSK, për nevoja të audiencës pjesëmarrëse në trajnimet e QSHTSK-së;
 - 1.3. Trajnim me prezencë online për programe trajnimi që pjesëmarrësit duhet të marrin pjesë për të ndjekur trajnimin e caktuar, nga kudo që kanë qasje në internet në kohë të caktuar online;
 - 1.4. Trajnim online për programe që lejojnë pjesëmarrësit të mësojnë me ritmin e tyre dhe nga kudo që kanë qasje në internet.

Neni 11

Trajnerët në QSHTSK

1. Në QSHTSK angazhohen këta lloj të trajnerëve, si:
 - 1.1. Trajnerët e përhershëm në QSHTSK të cilët janë të sistemuar në QSHTSK, si trajnerë në fushën e sigurisë kibernetike;
 - 1.2. Trajnerët e brendshëm janë stafi në kuadër të strukturës organizative nga personeli civil dhe ushtarak të MM-së dhe FSK-së përfshirë dhe pjesëtar të komponentit rezervë të FSK-së, si dhe sipas nevojës zyrtar publik nga institucionet tjera.

1.3. Trajnerët e jashtëm janë ekspertët e fushave jashtë institucioneve të administratës shtetërore, të cilët mund të angazhohen nga MM/FSK si trajner në fushat përkatëse.

1.4. Trajnerët ndërkombëtar janë trajnerët të cilët nuk janë shtetas të Kosovës dhe të cilët angazhohen sipas nevojës për mbajtjen e trajnimeve të caktuara nga MM/FSK.

Neni 12 **Angazhimi i trajnerëve në QSHTSK**

1. Trajnerët e përhershëm të QSHTSK – së, përzgjidhen në bazë të një procesi të hapur konkurrues në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Trajnerë të brendshëm të QSHTSK – së, përzgjidhen në bazë të një procesi të hapur konkurrues në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe angazhimi i tyre bëhet për zbatimin e programit të trajnimeve për të ofruar eksperiencat dhe aftësimet profesionale për stafin.
3. Trajnerët e jashtëm angazhohen kur ka mungesë të trajnerëve të brendshëm për trajnime të caktuara, dhe angazhimi i tyre bëhet në pajtim me dispozitën e *“Marrëveshjeve për shërbime të veçanta”* bazuar në Ligjin për Zyrtaret Publikë .
4. Trajnerët ndërkombëtar angazhohen kur trajnimet e caktuara nuk mund të realizohen nga trajnerët e brendshëm dhe të jashtëm, dhe angazhimi i tyre bëhet bazuar në marrëveshjet bilaterale të bashkëpunimit, apo mënyrës së kontraktimit të tyre bazuar në kriteret ligjore.

Neni 13 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Kryeministrit dhe publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

05 Janar, 2024